



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2021:265753

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05513439

**A.nr. 2802/21**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ të paditëses, ....., me adresë në ....., të cilën me autorizim e përfaqëson ..... avokat në ... kundër të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme – Agjencia e Regjistrimit Civil me seli në Prishtinë, me bazë juridike “anulim i vendimit”, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 26.03.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses .... nga .... dhe ANULOHEN aktvendimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme – Agjencia e Regjistrimit Civil me seli në Prishtinë me numër .... i datës 07.10.2021 dhe vendimi Nr.74/2021 i datës 05.11.2021 me numër protokolli 02/182 i datës 16.11.2021 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

II.Obligohet e paditura, të veprojë nga pikëpamja juridike e kësaj gjykate si dhe nga vërejtjet e dhëna lidhur me procedurën.

**A r s y e t i m**

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative(më tutje LKA-së ), në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur e ftuar me ftesë të rregullt (Provë: fletë kthesa e datës 06.03.2024).

I autorizuari i paditëses në padinë e datës 25.11.2021 dhe në seancën mbi shqyrtimin kryesor të datës 26.03.2024 ka deklaruar që mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë. I njëjti shton se, e paditura pa bazë

ligjore refuzon kërkesën e paditëses që në Regjistrin e Gjendjes Civile të regjistrojë emrin e babait të paditëses ..... Ai deklaroi se paditësja ka hapur procedurë civile në këtë çështje dhe me aktvendimin e Gjykatës se Apelit Ac.nr.8179/21 në faqen 3 të tij, vërtetohet se me vendimin e të paditurës, i cili është objekt i kërkesëpadisë në këtë procedurë, është vërtetuar se prindi i paditëses është ....., andaj e paditura duhet ta regjistrojë si të tillë. E paditura e ka refuzuar kërkesën e paditëses që të nxjerrë aktvendim, ngase e konsideron si çështje te kryer. Më tutje, shton se e paditura aktin e regjistrimit të atësisë e ka kushtëzuar me vendim të gjykatës, pa dhënë arsyetim në këtë çështje.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 14.03.2024 e kontestoi padinë e paditëses si të pa bazuar, duke theksuar se, vendimi i të paditurës është nxjerrë në harmoni me të gjitha dispozitat ligjore, andaj i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.03.2024, ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktvendimi i datës 07.10.2021 me nr. prot.01/016-01-109200/21; ankesa e dt.11.10.2021; aktvendimi dt. 28.01.1971 numër 7/436; Vërtetimi i fotokopjes nga dokumenti origjinal i vërtetuar te noteri me nr.13974/21; deklarata e dt.28.01.1971; aktvendimi i dt.31.08.2021; vendimi i dt.05.11.2021 me numër 74/2021 nr.prot.182; vendimi i dt.19.03.1965; fleta e pranimit të vendimit e dt.16.11.2021; shkresa e dt.18.10.2021; kërkesa e dt.14.09.2021; libri amzë i të martuarve fq.037; aktvendimi i dt.10.01.2024 numër A.c.nr.8179/21.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nga vendimet e kontestuara del se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 48 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsytet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të

përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar.

Gjykata gjen se me vendimin kontestues të paditurës të datës 05.11.2021 me numër 74/2021, me numër protokollin 02/182 të datës 16.11.2021, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e datës 11.10.2021 e paraqitur nga ....., për plotësimin e të dhënave të babilit në regjistrin themeltar të lindjes pranë ZGJC Pejë dhe pranuar nga Sekretaria e Komisionit në ARC me datë 18.10.2021 me nr. 01/138 dhe mbetet në fuqi Vendimi i Zyrës së Gjendjes Civile në Pejë me nr.01/016-01-109200/2021 e datës 07.10.2021, lidhur me kërkesën për plotësimin e të dhënave të babait në regjistrin themeltar të lindjes pranë ZGJC Pejë.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se *“Komisioni me rastin e vendosjes ka shqyrtuar provat e ofruara nga pala dhe është bazuar në Ligjin e Gjendjes Civile Nr.04/L-003, Neni 23 dhe Udhëzimit Administrativ (ARC) Nr.01/2016, Neni 7, paragrafi 3 dhe Neni 6 i këtij Udhëzimi Administrativ”*.

Gjykata vëren se në arsyetimin e vendimit kontestues e paditura vetëm e ka cekur ligjin dhe Udhëzimin Administrativ ku është bazuar me rastin e refuzimit të ankesës së tani paditëses ....., duke mos e vlerësuar asnjë provë të ofruar nga paditësja, mbi bazën e të cilave do ta vlerësonte se cilat kushte i ka plotësuar, e cilat kushte nuk i ka plotësuar paditësja, e më pas të vendoste lidhur më kërkesën e saj.

Në shkresat e lëndës gjykata gjen se, me aktvendimin me numër 02 nr.7/436 ( të tjerë numra nuk duken) të vitit 11.09.1969 të lëshuar nga Kuvendi i Komunës së Pejës, është lejuar regjistrimi me vonesë në Librin Amzë së të Lindurve për paditësen ....., ku theksohet se prindërit e saj janë i ati ..... dhe e ëma .....

Gjykata konsideron se ky aktvendim është i vlefshëm, pasi është lëshuar nga organi kompetent dhe nuk është kundërshtuar në atë kohë nga asnjëri prind i paditëses.

Ndërsa sa i përket mbiemrit të paditëses, në shkresat e lëndës gjendet deklarata e datës 28.01.1971 në Pejë nga ....., e ëma e këtij paditëses, ku e njëjta deklaroi se: si nënë dëshiron që fëmija të regjistrohet në mbiemrin e saj - ....., sepse ende nuk ka arritur që të bjerë dakord që fëmija të regjistrohet në emrin e ..... Pra, nëna asnjëherë nuk e ka kundërshtuar se ..... është babai i ..... por vetëm ka theksuar që *“ ende nuk kemi mbrri me ra dakort që fëmija të regjistrohet në emrin ..... ”*.

Andaj, gjykata konstaton se, çështja nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë në organin e paditur, pasi që edhe me aktvendimin e datës 31.08.2021 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, në arsyetimin e të njëjtit vendim, gjykata ka konstatuar se, pasi që në aktvendimin nr.02 Nr.7/436 të datës 11.09.1969, rezulton konstatimi, që prindërit e paditëses janë ..... dhe ....., andaj si mund të vërtetohet një fakt i vërtetuar. Pra, gjykata ka konstatuar se është fakt i vërtetuar se ..... është babai i fëmiut ..... këtu paditëses ....., e regjistruar në librin amzë të të lindurve me mbiemrin e nënës ....., ndërsa pas martesës, sipas librit amzë të të martuarve me mbiemrin .....

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur me padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për Çështje Administrative  
A.nr.2802/2021 data: 26.03.2024

G j y q t a r e  
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.